



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

Specififikimet Teknike

(Për projektin: Rikonstruksion i Rrugës Shtjefen Gjecovi-Haxhi Xhyheri)

Specifikime teknike

- **Shtresë stabilizanti $t=10\text{cm}$ (Nështresa me material të granular).**

Ky zë parashikon ndërtimin e nënshtresës me stabilizant (çakëll i thyer dhe i granular). Shtresat e stabilizantit duhet të jenë të granuluara me fraksione 0-20mm.

Shtresa e stabilizantit e ngjeshur do të plotësojë të gjitha kërkesat për trashësinë, kuotën, seksionin tërthor dhe densitetin. Trashësia e shtresës (base) e ngjeshur duhet të jetë $t=10\text{cm}$ dhe uniforme.

- **Shtresat asfaltike**

- Shtresa e binderit (ose asfaltobetoni poroz). Kjo shtrese përdoret për shtresën lidhëse ndërmjet shtresës së stabilizantit dhe shtresës së asfaltobetonit. Materiali për shtresën e binderit (asfaltobetoni poroz) përgatitet me 60 deri 75% çakëll të thyer, 20 deri në 35% rërë dhe që mbas ngjeshjes ka porozitet mbetës 5 deri 10% në vëllim. Në varësi të kategorisë së rrugës kjo shtresë parashikohet të realizohet me trashësi $t=3\text{cm}$ ose 4cm .

- Shtresa e Asfaltobetonit (asfaltobeton i ngjeshur). Kjo shtresë përdoret si shtresë përdoruese (shtresa konsumuese). Materiali për këtë lloj shtrese përgatitet me çakëll të thyer e granal në masë 35 deri 40%, rërë 50% dhe pluhur 5 deri 15% dhe që mbas ngjeshjes ka porozitet mbetës në masën 3 deri ne 5% në volum. Në varësi të kategorisë së rrugës kjo shtresë parashikohet të realizohet me



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

trashësi $t=5\text{cm}$ ose 6cm . Për rastet kur parashikohet profilim me binder kjo shtresë do realizohet me trashësi mesatare tmes.= 3cm .

Asfaltobetoni duhet te përgatitet në fabrika të posaçme, të cilat këshillohet të jenë sa më afër vendit të përdorimit të tij. Temperatura e masës së asfaltobetonit mbas shkarkimit nga përzierësi duhet të jetë në kufijtë $140-160$ gradë celsius. Kur temperatura e mjedisit të jashtëm ku do kryhen punimet është 5 deri në 10 gradë celsius, kufiri më i ulët i temperaturës së asfaltobetonit duhet të jetë jo më pak se 150 gradë Celsius.

Transporti i asfaltobetonit duhet të bëhet me mjete vetëshkarkuese. Karroceria e tyre para ngarkesës duhet të jetë e pastër, e thatë dhe e lyer me përzieres solari të holluar me vajgur, për të mënjanuar ngjitjen e masës së asfaltobetonit. Këshillohet që karroceria e mjetit të jetë e mbuluar, për të mbrojtur asfaltobetonin nga lagështia dhe te ngadalësojë shpejtësinë e ftohjes së masës gjatë transportit.

Shtrimi dhe ngjeshja e asfaltobetonit

- a) Ndërtimi i shtresave asfaltike rrugore fillon të kryhet mbasi të kenë përfunduar punimet e themelit (nënshtresat rrugore) dhe të jenë plotësuar treguesit teknik, në lidhje me ngjeshmërinë ose aftësinë mbajtëse të tyre, kjo në përputhje me kërkuesat e projektit.
- b) Trashësia e shtresës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit (në gjendje të shkrifët) duhet të jetë 1.20% deri 1.25% më me e madhe se trashësia e dhënë në projektzbatim në gjendje të ngjeshur.
- c) Temperatura e masës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit në rrugë duhet të jetë në kufijtë $130-150$ gradë Celsius. Në kohë të nxehtë jo më pak se 130 gradë celsius dhe në kohë të ftohtë (kur temperatura e mjedisit të jashtëm është $5-10$ gradë celsius të jetë jo më pak se 140 gradë celsius.
- d) Ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit duhet të kryhet menjëherë mbas shtrimit të tij në rrugë. Cilindri ngjeshës duhet të ndjekë nga pas makinerinë asfaltoshtruese duke qëndruar në largësi deri 4m , me qëllim që ngjeshja të kryhet në gjendje sa më të nxehtë.
- e) Për rrugë me pjesë kaluese mbi 5.0m , ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit për gjysmën e parë të rrugës fillon nga kufiri me bankinën, ndërsa për gjysmën tjetër nga fuga gjatësore, e cila mund të jetë aksi i rrugës.
- f) Makineritë që përdoren për ngjeshjen e shtresave të asfaltobetonit duhet të jenë rula të zakonshëm me pesha të ndryshme nga 5 deri në 12 ton ose rula me vibrim.



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

g) Kur përdoren për ngjeshje rula të zakonshëm, numri i kalimeve luhatet në kufij 12 deri 17 herë, ndërsa kur përdoren rula vibrues, numri i kalimeve ulet në masën deri 50%.

k) Në fillim të ngjeshjes, cilindri në kalimet e para (deri 4 kalime) duhet t'a bëjë në të gjithë sipërfaqen e shtresës së asfaltobetonit duke ecur me shpejtësi 2 deri ne 2.5km/orë. Ngjeshja duhet të bëhet me kujdes, në mënyrë që të mënjanohen rrudhosjet e shtresës.

l) Në kohë të nxeh të, fillimi i ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit bëhet me rulo me peshë të lehtë 5 deri 7 ton dhe më pas vazhdohet me rulo me peshë 10 deri ne 12 ton, ndërsa ne kohë të ftohtë, ngjeshja fillohet me rulo të rëndë 10 - 12 ton dhe më pas vazhdohet me rulo të lehtë, shpejtësia e lëvizjes së rulit duhet të jetë në kufijtë 2 deri 4km/orë.

m) Në rastet kur është e pamundur të futen makineritë ngjeshja e shtresës asfaltike mund të kryhet me tokmak ose pllaka të nxehta.

n) Cilindri ngjeshës në çdo kalim duhet të shkelë në gjurmë e mëparshme jo më pak se 0.25 të gjerësise së tij.

o) Ngjeshja e asfaltobetonit quhet e përfunduar atëherë kur mbi sipërfaqen e asfaltuar cilindri gjatë kalimit të tij nuk lë më gjurmë.

p) Cilindri i rulit gjatë punës për ngjashjen shtresës së asfaltobetonit duhet të lyhet vazhdimesh me solucion solari të holluar me vajgur për të mënjanuar ngjitjen e kokrrizave të bituminuara në të.

q) Nuk lejohet që ruli të qëndrojë në shtresën e asfaltobetonit të pangjeshur plotësisht ose të bëjë manovrime të ndryshme mbi të.

t) Kur shtrimi i asfaltobetonit kryhet pa ndërprerje dhe përbëhet nga dy shtresa, këshillohet që shtresa e asfaltobetonit (shtresa konsumuese) të bëhet 24 orë pas hedhjes së shtresës së binderit.

u) Për të mënjanuar rrudhosjen e shtresave të asfaltobetonit në rrugët, që kanë pjerrësi gjatësore mbi 6% është e domosdoshme që të sigurohet sipërfaqe e ashpër e shtresës së asfaltobetonit duke përdorur për prodhimin e tij çakëll kokërrmadh dhe ngjeshja me cilindër të kryhet duke filluar nga pjesa më e ulët.

v) Fugat të cilat krijohen gjatë shtrimit të asfaltobetonit në kohë të ndryshme duhet të trajtohen me kujdes te veçantë, për të mënjanuar boshillëqet që mund të krijohen në to.

Këshillohet që të respektohen rregullat që vijojnë:



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

v-1) Fugat midis shtresës së binderit dhe shtresës përdoruese të asfaltobetonit duhet që në çdo rast të jenë të larguara nga njëratjetra në kufijtë 10 deri 20cm.

v-2) Para fillimit të shtresës pasardhëse të asfaltobetonit, shtresa e mëparshme duhet të pritet me daltë duke e bërë fugën të pjerrët me kënd 45 gradë.

v-3) Para fillimit të shtresës së asfaltobetonit fuga lyhet me bitum dhe në buzë të saj vendoset listelë druri, e cila kufizon trashësinë e asfaltobetonit të shkrifët dhe nuk lejon asfaltin e freskët mbi shtresën e ngjeshur më parë. Kur fillon ngjeshja hiqet listela dhe cilindri duhet të bëjë ngjeshjen duke shkelur jo më pak se 20cm fugën. Mbas përfundimit të ngjeshjes, fuga në të dyja anët e saj në një gjerësi prej 6cm duhet të lyhet me bitum.

w) Në rastet kur shtresa e asfaltobetonit (shtresa konsumuese apo përdoruese) shtrohet mbasi shtresa lidhëse (binderi) i është nënshtruar me parë lëvizjeve te automjeteve, duhet detyrimisht të pastrohet sipërfaqja e saj nga papastërtitë e pluhuri, të mos përmabajë lagështi dhe të spërkatet me bitum të lëngshëm (në sasi deri 0.6 kg/m²) para fillimit të hedhjes së shtresës asfaltobetonit (shtresa konsumuese apo përdoruese).

Kontrolli mbi cilësinë e asfaltobetonit të shtruar

a) Sipërfaqja e shtresës së asfaltobetonit duhet të jetë e lëmuar, e rrafshët dhe e njëtrajtshme, të mos ketë plasaritje, gungëzime ose valëzime, të mos ketë porozitet e ndryshime në kuota. Shtresa asfaltike duhet te kete pjerrësi dhe trashësi, sipas detajit të dhënë në projektin e zbatimit.

b) Ndryshimet në kuotat anësore të rrugës nuk duhet të jenë më shumë se 20mm në krahasim me kuotat e përcaktuara në profilin tërthor të projektit.

c) Valëzime të matura si në drejtësim tërthor, ashtu dhe në atë gjatësor të rrugës nuk duhet të jenë më shumë se 5 mm.

d) Ndryshimet në trashësinë e shtresës krahasuar me ato të përcaktuara në projekt nuk duhet të jenë më shumë se 10%.

e) Kontrolli që përcakton cilësitë kryesore të asfaltobetonit të vendosur e ngjeshur në vepër përcaktohen me prova laboratorike. Për këtë qëllim për çdo segment rruge të përfunduar ose për sasi deri në 2500m² asfaltobetonit të shtruar rruge, nxirren mostra me madhësi 25 x 25 cm mbi të cilat kryhen prova laboratorike për përcaktimin e vutive



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

fiziko-mekanike. Vlerat e tyre krahasohen me kërkesat e projektit ose të STASH 660-87.

f) Për cdo segment rruge të shtruar me asfaltobeton duhet të mbahet akt-teknik, ku të pasqyrohen të gjitha të dhënat e kontrollit me pamje, matje e laboratori dhe të miratohet nga përfaqësuesit e investorit dhe firmës zbatuese, kur treguesit cilësorë janë brenda kufijve të kërkuar nga projektuesi ose kushtet teknike.

Kontrolli i cilësisë

Sipërmarrësi do të punësojë inxhinier të kualifikuar, të specializuar dhe me eksperiencë, i cili do të jetë përgjegjës për kontrollin e cilësisë të të gjithë betonit. Materialet dhe mjeshtëria e përdorur në punimet e betonit duhet të jetë e një cilësie sa më të lartë që të jetë e mundur, prandaj vetëm personel me eksperiencë dhe aftësi të plotë në këtë kategori punimesh do të punësohet për punën që përfshin ky seksion specifikimesh.

Betoni duhet të përzihet uniformisht në fabrika moderne përzjerjeje për prodhimin e betonit të nevojshëm për plotësimin e punës brenda kohës së përcaktuar pa zvogëluar kohën e nevojshme për përzjerje. Betoni duhet të përzihet në përzjerësa betoni për kohëzgjatjen e kërkuar për shpërndarjen uniforme të përbërësve për të prodhuar një masë homogjene me ngjyrë dhe fortësi por jo më pak se 1-1/2 minutë.

Përzjerësi duhet të përdoret nga punëtorë të specializuar që kanë eksperiencë të mëparshme në drejtimin e përdorimin e përzjerësit të betonit.

Në asnjë mënyrë nuk duhet që betoni të përzihet me dorë pa miratimin e Mbikëqyresit të Punimeve, miratim ky që do të jepet vetëm për sasi të vogla në kushte të veçanta.

Hedhja e betonit në vepër dhe trajtimi

Sipërmarrësi duhet të ketë aprovin e Mbikëqyrësit të Punimeve për masat e propozuara përpëra se të fillojë betonimin.

Të gjitha vendet e hedhjes dhe të ngjeshjes së betonit, duhet të mbahen në mbikëqyrje të vazhdueshme nga pjesëtarët përkatës të ekipit të Sipërmarrësit.

Sipërmarrësi duhet të ndjekë nga afër ngjeshjen e betonit, si një punë me rëndësi të madhe, objekt i të cilit do të jetë prodhimi i një betoni të papërshkueshëm nga uji me një densitet dhe fortësi maksimale.

Betoni duhet të përgatitet në impiantet e prodhimit sipas formulës përkatëse për markën e kërkuar.



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

Betoni duhet të hidhet sa është i freskët dhe para se të ketë fituar qëndrueshmërinë fillestare, dhe në çdo rast jo më vonë se 30 minuta pas përzjerjes.

Nuk do të lejohet asnje metodë që nxit ndarjen apo veçimin e pjesëve të trasha dhe të holla, apo që lejojnë derdhjen e betonit lirisht nga një lartësi më e madhe se 1.5m.

Kur hedhja e betonit ndërpritet, betoni nuk duhet në asnje mënyrë të lejohet të formojë skaje apo anë, por duhet të ndalohet dhe të forcohet mirë në një ndalesë të ndërtuar posaçërisht dhe të formuar mirë për të krijuar një bashkim konstruktiv efikas.

Menjëherë para se të hidhet betoni tjetër, sipërfaqet e të gjitha fugave duhet të kontrollohen, të pastrohen me furçë dhe të lahen me llaç të pastër.

Para se betoni të hidhet në vepër duhet të kontrollohet nga mbikqyrësi i punimeve. Duhet të ndërmerrin masa paraprake për të parandaluar ujërat nëntokësore që dëmtojnë betonin e pa hedhur ose që shkaktojnë lëvizjen e betonit.

Aty ku është e nevojshme apo e kërkuar nga Mbikëqyrësi i Punimeve, betoni duhet të vibrohet gjatë hedhjes me vibratorë të brendshëm, të aftë për të prodhuar vibrime jo më pak se 5000 cikle për minutë.

Sipërmarrësi duhet të tregojë kujdes për të shmangur kontaktin midis vibratorëve dhe përforcimit, dhe të evitojë veçimin e inerteve nga vibrimi i tepërt. Vibratorët duhet të vendosen vertikalishët në beton 500 mm larg dhe të tërhoqen gradualisht kur flluckat e ajrit nuk dalin më në sipërfaqe.

Kostot e sipërmarrësit për mobilizim dhe punime të përkohëshme

Do të kihet parasysh që Sipërmarrësit nuk do t'i bëhet asnje pagesë mbi çmimet njësi të kuotuara për kostot e mobilizimit të kantierit të ndërtimit, d.m.th. për sigurimin e transportit, energjinë, veglat dhe pajisjet ose për furnizimin e godinës dhe mirëmbajtjen e impjanteve të ndërtimit, rrugëve të hyrjes, të komoditeteve sanitare, heqjen e mbeturinave, furnizimin me ujë, mbrojtjen kundra zjarrit, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura të tjera të përkohëshme, pajisje dhe materiale, ose për kujdesin mjekësor dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, ose për patrullat dhe rojet, ose për ndonjë shërbim tjetër, ose materiale të nevojshme ose që kërkohen për zbatimin e punimeve në përputhje me atë që do të parashikohet në Kontratë.

Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhë të jetës publike, si edhe të pasurive në dhe rrëth sheshit të ndërtimit.



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

Gjatë zbatimit të punimeve Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të vendosi dhe të mirëmbajë gjatë gjithë kohës pengesa të tilla dhe drita, të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë pengesa të përshtatëshme, shenja me dritë të kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të shkaktojnë çrrregullime të trafikut normal ose që përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

Mbrojtja e ambjentit

Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet, terreni dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

Transporti i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Sipërmarrësi do të bëhet me makina të përshtatëshme të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson ketë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri.

Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punimeve në kantier Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi i ndërtimit të gjitha impiantet ndërtimore, materialet e teperta, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kushte të pranueshme. Pagesa përfundimtare e Kontratës do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Mbikëqyrësi i Punimeve.

Siguria në kantier (Perfshire Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin)

Kjo rubrike bazohet ne Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë per kete rubrike perllogaritet në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet dhe parashikohet ne masen jo me pak se 3% e fondit limit e shprehur ne vlore 17,250,000 leke pa tvsh. Kjo vlore minimale shërben për zbatimin e masave për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier",



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

Aneksi VI "Permbajtja minimale e planit te sigurise ne kantieret e perkoheshme e te levizeshme".

Sekzioni 1 - Përmbajtja minimale e përgjithshme e planit të sigurisë e koordinimit (PSK).

PSK përmban të paktën elementet e mëposhtme:

- a) identifikimin dhe përshkrimin e objektit, duke specifikuar:
 - 1. adresën e kantierit;
 - 2. një përshkrim përbledhës të zonës në të cilën është pozicionuar kantieri, i shoqëruar me skicë;
 - 3. një përshkrim sintetik të objektit, duke iu referuar në mënyrë të veçantë zgjidhjeve të projektimit, arkitektonikë, strukturore dhe teknologjikë;
- b) përcaktimin e subjekteve që kanë funksionin e sigurisë, duke treguar emrat e përgjegjësve për punimet, të koordinatorit për sigurinë në fazën e projektimit, dhe nëse është emëruar, të koordinatorit për sigurinë në fazën e kryerjes së punimeve dhe emrin e punëdhënësve për subjektet zbatuese dhe punëmarrësit e vetëpunësuar para fillimit të punimeve;
- c) një relacion në lidhje me përcaktimin, analizën dhe vlerësimin e rreziqeve konkrete duke iu referuar zonës dhe organizimit të kantierit, punimeve dhe ndërhyrjeve në to;
- d) zgjidhjet e projektimit dhe të organizimit, procedurat, masave parandaluese dhe mbrojtëse, në referim me:
 - 1. zonën e kantierit, në përputhje me sektionin 2, pikat 1 dhe 4;
 - 2. organizimin e kantierit, në përputhje me sektionin 2 pikat 2 dhe 4;
 - 3. punimet, në përputhje me sektionin 2 pikat 3 dhe 4;
- e) përshkrimet operative, masat parandaluese e mbrojtëse dhe mekanizmat e mbrojtjes individuale, në referim me ndërfutjet midis aktiviteteve, në përputhje me sektionin 3 pikat 1,2 dhe 3;
- f) masat e koordinimit, me përdorimin e përbashkët nga shumë subjekte dhe punëmarrësve të vetëpunësuar, si; zgjedhja e planifikimit të aktiviteteve për sigurinë, struktura, pajisje, infrastruktura, shërbime dhe mjete të mbrojtjes kolektive si në sektionin 2 pikat 4 dhe 5;



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

g) mënyrat e organizimit të bashkëpunimit dhe koordinimit, si dhe të informacioneve reciproke, midis punëdhënësve dhe punëmarrësve të vetëpunësuar;

h) parashikimi i organizimit për shërbimin e ndihmës së shpejtë, kundër zjarrit dhe evakuimit të punëmarrësve; PSK përmban dhe të dhëna telefonike të strukturave të parashikuara në territorin e shërbimit të ndihmës së shpejtë dhe të parandalimit të zjarreve;

i) parashikimin e kohëzgjatjes së punimeve, fazat e punimeve dhe kur e kërkon kompleksiteti I objektit, dhe të nënfasave të punimeve, që përbëjnë programin grafik të punimeve, si dhe përbërjen e kantierit të shprehur në njerëz - ditë;

j) vlerësimi i kostove të sigurisë, në bazë të seksionit 6.

3. Koordinatori për projektin specifikon në PSK, aty ku veçantia e punimeve e kërkon, tipin e procedurave plotësuese dhe të detajeve të PSK lidhur me vendimet e pavarura të subjektit zbatues, që duhet të specifikohen në POS.

4. PSK është i përbërë nga tabela specifike për projektin, në lidhje me aspektet e sigurisë, që përfshijnë të paktën një planimetri, dhe aty ku e kërkon veçantia e objektit, një profil altimetrik dhe një përshkrim i shkurtër i karakteristikave hidrologjike të terrenit ose referim i specifikimeve të relacionit të gatshëm, nëse ekziston.

5. Lista treguese dhe jo e kufizuar e elementeve esenciale të nevojshme për të përcaktuar përbajtjen e PSK të cituar në pikën 2, është si më poshtë:

- a) strukturat përfshijnë: skelat, skela prej tubash mbi rrota, ura mbi trekëmbësh, pjesa horizontale e skelave, parapete, rrugë kaluese, ura, armatura mbrojtëse të gjermimeve, banja, lokale për t'u larë, dhoma zhveshje, mensa, dhomat e ngrënies, vende kurimi dhe pushimi; konvikte; dhoma mjekimi, infermieri, hapësira të myllura në kantiere;
- b) pajisjet përfshijnë: centrale dhe impiantet e betonimit; betonierat, vinça, vinçat auto, krikat, elevatorë, makinat përlëvizjen e dheut, makinat speciale përlëvizjen e dheut dhe derivate, sharra elektrike disk, kthyes hekuri, impiantet elektrike të kantiereve, tokëzimet dhe mbrojtja kundër shkarkimeve elektrike, impiantet kundër zjarreve, impiantet e thithjes së tymrave, impiantet e transmetimit të ujit, gazit dhe çdo lloj tjetër energjie, rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza;
- c) Infrastruktura përfshin: rrugët e transportit të mjeteve mekanike në kantier, rrugët e këmbësorëve; zonat e depozitimit të materialeve dhe mbeturinave të kantierit.



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

d) pajisjet dhe shërbimet e mbrojtjes kolektive përfshijnë, sinjalistikën e sigurisë, paralajméruesit akustik, mjetet e ndihmës së shpejtë, ndriçimi i emergjencës, mjetet shuarjes së zjarrit; shërbimet për drejtimin e emergjencës.

Sekzioni 2 - Përbajtja minimale e PSK në lidhje me zonën e kantierit, organizimit të kantierit dhe punimeve.

1. Në lidhje me zonën e kantierit, PSK përmban analizën e elementeve kryesorë në lidhje me shtresat nëntokësore, burime ujore, mole, pemë, punime të ndërfutura ose mbi të cilët duhet ndërhyrë, infrastruktura, ndër të cilat, rrugë, linja hekurudhore, rrjeti ujor, aeroporte, ndërtesa që kërkojnë kujdes të veçantë, si shkollat, spitalet, shtëpitë e pushimit për moshat e thyera, banesa; linjat ajrore dhe tubacionet e nëndheshme të shërbimeve, kantiere të tjera ose instalime për prodhim; qarkullimi, zhurma, pluhurat, fibra, tymra, avuj, gaze, erëra ose ndotës të tjerë të ajrit, rënien e materialeve nga lartësitë. Në lidhje me elementet e mësipërme në PSK duhet të analizohen përkatësisht:

- a) karakteristikat e zonës së kantierit;
- b) prania a mundshme e faktorëve të jashtëm që sjellin rrezik për kantierin;
- c) rreziqe të mundshme që shkaktohen nga punimet në kantier në zonat rreth tyre.

2. Në lidhje me organizimin e kantierit, PSK përmban dhe elementet që vijojnë:

- a) mënyrat e mundshme për hyrjen e mjeteve të furnizimit të materialeve;
- b) pozicionin e impianteve të kantierit;
- c) pozicionin e zonave të ngarkim - shkarkimit;
- d) zonat e depozitimit të mjeteve dhe të depozitimit të materialeve dhe të mbeturinave;
- e) zonat e mundshme të depozitimit të materialeve me rrezik zjarri ose eksplozim.

3. Në lidhje me punimet, koordinatori për projektin bën ndarjen e punimeve në faze dhe kur kompleksiteti i objektit e kërkon, në nënfasa të punës, dhe kryen analizën e rreziqeve të mundshme, duke treguar kujdes për sa vijon:

- a) mbi rrezikun e përplasjes së mjeteve që qarkullojnë në zonën e kantierit;
- b) mbi rrezikun e shkarkesave elektrike
- c) mbi rrezikun e zhurmës
- d) mbi rrezikun nga përdorimi i substancave kimike.



Bashkia Vlore
Drejtoria e Urbanistikes

4. Për çdo element të analizës në pikat 1, 2 dhe 3, PSK përmban:
- a) zgjedhjet e projektimit dhe organizimit, procedurat, masat parandaluese e mbrojtëse të kërkaura për të zvogëluar ose eliminuar rrezikun në punë; kur është e nevojshme, prodhohen tabela dhe vizatime teknike shpjegues;
 - b) masat e koordinimit për realizimin e kërkeseve të përmendura në shkronjën "a".

Sekzioni 3 - Përbajtja minimale e PSK në lidhje me ndërhyrjet për ndryshimin e punimeve dhe koordinimin e tyre.

1. Koordinatori për projektimin kryen analizën e ndryshimit të punimeve, edhe kur bëhet fjalë për punimet, zbatimit nga i njëjti subjekt ose të punëmarrësve të vetëpunësuar, përgatit një program kohor për zbatimin e punimeve.
2. Në lidhje me ndërhyrjet për ndryshim punimesh, PSK mban shënimet operative për shtyrjen e afateve kohore të punimeve të ndryshuara dhe mënyrat e verifikimit në lidhje me këto shënime; në rastin kur vazhdon rreziku i ndryshimeve, merren masa parandaluese dhe mbrojtëse dhe pajisjet e mbrojtjes personale, për të zvogëluar këto rreziqe.
3. Gjatë kohës së një rreziku më të madh për shkak të ndërhyrjeve për ndryshim në punë, koordinatori për kryerjen e punimeve, kontrollon periodikisht, duke konsultuar paraprakisht drejtuesin e subjekteve zbatuese dhe të punëmarrësve të vetëpunësuar të interesuar, pajtueshmërinë e pjesës përkatëse në PSK me ecurinë e punimeve, duke përditësuar planin dhe në mënyrë të veçantë, nëse është e nevojshme, programin kohor për zbatimin e punimeve.
4. Masat për koordinimin në lidhje me përdorimin e përbashkët të strukturave, infrastrukturës, mjeteve, dhe shërbimeve të mbrojtjes kolektive, përcaktohen duke analizuar përdorimin e përbashkët nga shumë subjekte dhe punëmarrës të vetëpunësuar.
5. Koordinatori për zbatimin e punimeve, plotëson PSK me emrat e subjekteve zbatuese dhe të punëmarrësve të vetëpunësuar, të cilët duhet të zbatojnë çfarë është parashikuar në pikën 4 të sektionit 2 dhe në pikën 4 të sektionit 3, duke konsultuar paraprakisht subjektet zbatuese dhe punëmarrësit e vetëpunësuar të interesuar, tregon gjithashtu kronologjinë përkatëse të zbatimit dhe mënyrat e kontrollit.

Sekzioni 4 - Përbajtja minimale e planit rezervë të sigurisë -PRS.

1. PRS hartohet nga zbatuesi i punimeve, nën kujdesin e autoriteti kontraktor, si plani rezervë i planit të sigurisë dhe koordinimit,



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

kur ai nuk është parashikuar në përputhje me pikën 3 të seksionit 3 dhe përmban të njëjtat elemente të PSK të cituara në pikën 2 të seksionit 1, me përjashtim të vlerësimit të kostos për sigurinë.

Sekzioni 5 - Përbajtja minimale e planit operativ të sigurisë

1. POS hartoheq nga çdo punëdhënës i subjektit zbatues, në përputhje me nenin 9, dhe modifikimet e mëtejshme, për secilin kantier të interesuar;

Ky plan përmban të paktën elementët e mëposhtme:

a) të dhënat identifikuase për subjektet zbatuese:

1) emrin e punëdhënësit, adresën, të dhënat telefonike të zyrës qendrore dhe të zyrave të kantiereve;

2) aktivitetet specifice dhe çdo punim të kryer në kantier nga subjekti zbatues dhe punëmarrësit të vetëpunësuar nënkontraktues;

3) emrat e personelit për ndihmën e shpejtë, veprimet kundër zjarrit, evakuimin e punëmarrësve dhe të drejtimit të emergjencës në kantier, të përfaqësuesit të punëmarrësve për sigurinë e ndërmarrjes ose të territorit, i emëruar ose i zgjedhur;

4) emri i mjekut kompetent aty ku parashikohet;

5) emri i përgjegjësit për zyrën e parandalimit e të mbrojtjes;

6) emri i drejtorit teknik të kantierit dhe të përgjegjësit të kantierit;

7) numri dhe kualifikimet për çdo punëmarrës vartës të firmës zbatuese dhe të punëmarrësve të vetëpunësuar që punojnë në kantier për llogari të të njëjtit subjekt.

b) detyrat specifice, të lidhura me sigurinë, të kryera në kantier nga çdo person I emëruar për këtë qëllim nga subjekti zbatues;

c) përshkrimi i aktiviteteve të kantierit, mënyrat e organizmit dhe turnet e punës;

d) lista e skelave, urave kulle mbi rrota dhe e objekteve të tjera provizore me rëndësi, e makinerive dhe e impianteve që përdoren në kantier;

e) listën e substancave dhe preparateve të rrezikshme që përdoren në kantier me skedat përkatëse të sigurisë;

f) rezultatin e raportit të vlerësimit për zhurmën;

g) përcaktimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse, të plotësuara me ato të përfshira në PSK, dhe të adoptuara me rreziqet e lidhura me punimet në kantier;

h) procedurat plotësuese e të detajuara, të kërkua nga PSK;

i) lista e pajisjeve të mbrojtjes personale të vëna në dispozicion të punëmarrësve në kantier;

l) dokumentet në lidhje me informacionin dhe formimin e dhënë, punëmarrësve në kantier.

2. Aty ku nuk parashikohet hartimi i PSK, PRS plotësohet me elementet e POS kur është e parashikuar.



Bashkia Vlore

Drejtoria e Urbanistikes

Autoriteti Kontraktor bën likujdimin e vlerës së sipërcituar për sigurinë në kantier në cdo situacion respektiv referuar peshës korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqëruar me (i) raportin PSK (referuar përbajtjes minimale të PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistët e HSE (Health, Safety and Environment) të autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nëse nga monitorimi i specialistëve të HSE dhe/apo Mbikqyresit të punimeve rezulton se nuk janë zbatuar masat e sigurisë në kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) përvec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK të kontratës, vlera korresponduese për këtë rubrikë nuk do të paguhet për situacionin respektiv referues.

Ing. Darjan Hudhra